

VENDIM
Nr. 310, datë 30.11.2022

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 27, DATË 29.1.2021, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘AGETA’ SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC ‘BORIE–LURË 1’, ME KAPACITET TË INSTALUAR 1800 kw”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.11.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1999/2 prot., datë 23.11.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 27, datë 29.1.2021, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Ageta’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Borie–Lurë 1’, me kapacitet të instaluar 1800 kw’, i ndryshuar”, konstatoi se:

- ERE, me vendimin nr. 27, datë 29.1.2021, të ndryshuar, ka vendosur:

1. Të licencojë shoqërinë “Ageta” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Borie–Lura 1”, me kapacitet të instaluar 1800 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria të dokumentojë në ERE brenda 3-muajve miratimin/njoftimin nga MIE të shoqërisë “Ageta” sh.p.k. si përfaqësuese dhe zbatuese në vijim të kontratës nr. 65 rep., nr. 38/1 kol., datë 16.1.2018, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Borie–Lurë 1”, me kapacitet prodhues 1800 kw, në rrjedhën e përrënjeve të kurorës së Lurës, degë e lumit Drin i Zi, Bashkia Dibër, qarku Dibër, pas tërheqjes/largimit të shoqërisë “Bajrami N”. (Shfuqizuar me vendimin e Bordit nr. 104, datë 22.4.2021, pas plotësimit nga shoqëria.)

3. Në përfundim të afatit të kontratës së qirasë me Bashkinë Dibër (data e përfundimit 16.11.2027), shoqëria duhet ta depozitojë atë me afate të rinovuara, jo më vonë se një muaj pas nënshkrimit të rinovimit.

4. Në përfundim të afatit të lejes së përdorimit të burimit ujor (data e përfundimit 9.4.2022), do t’i kërkohet shoqërisë ta depozitojë atë me afate të rinovuar një muaj pas rinovimit të saj.

5. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

Me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 840/1, datë 1.6.2022, shoqëria “Ageta” sh.p.k. ka bërë me dije se ka aplikuar dhe është në pritje të rinovimit të lejes ujore nga ana e Agjencisë së Mbrojtjes së Burimeve Ujore (AMBU).

ERE, në vijim të takimit të datës 2.6.2022, me përfaqësues të AMBU-së ka shkëmbyer korrespondencën të vazhdueshme me këtë institucion ku së fundi edhe me shkresën nr. 1833 prot., datë 18.10.2022, në lidhje me konstatimin e AMBU-së se disa HEC-e ushtrojnë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike pa pasur leje për përdorim të burimit ujor. Ndër të tjera, ERE i ka kërkuar informacion AMBU-së në lidhje me mënyrën sesi do të konsiderohen subjektet që kanë aplikuar për rinovimin e lejes për përdorimin e burimit ujor dhe gjatë këtij procesi i përfundon afati i vlefshmërisë së lejes me të cilën është pajisur, sikurse rasti i shoqërisë “Ageta” sh.p.k., së cilës i ka përfunduar leja në datën 9.4.2022 dhe ka bërë me dije ERE-n se ka aplikuar për rinovimin e saj në datën 24.3.2022.

Në përgjigje të sa më sipër me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 1833/1, datë 21.10.2022, AMBU-ja, ndër të tjera, ka kthyer përgjigje edhe për shoqërinë “Ageta” sh.p.k., duke cilësuar se kjo shoqëri ka aplikuar për rinovimin e lejes së përdorimit të burimit ujor për HEC “Borie–Lurë” dhe aplikimi është në fazë trajtimi nga organet e menaxhimit të burimit ujor.

Në vijim, me shkresat nr. 840/2 prot., datë 4.11.2022 dhe nr. 840/4 prot., datë 15.11.2022, shoqëria “Ageta” sh.p.k. ka depozituar vendimin nr. 31, datë 20.10.2022, për miratimin e saktësimit të koordinatave dhe rinovimin e lejes, HEC ‘Borie–Lurë 1’ dhe lejen për përdorim burimi ujq sipërfaqësor nr. 433, datë 24.10.2022, me afat vlefshmërie 5 vjet.

Me depozitimin e dokumentacionit si më sipër nga shoqëria “Ageta” sh.p.k., vlerësojmë që pika 4 e vendimit të Bordit nr. 27/2021, i ndryshuar, të ndryshojë dhe bëhet:

“4. Në përfundim të afatit të lejes së përdorimit të burimit ujq (data e përfundimit 24.10.2027), do t’i kërkohet shoqërisë ta depozitojë atë me afat të rinovuar.”.

Në nenin 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” ka parashikuar mundësinë e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit, që ka nxjerrë aktin, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 3 e vendimit të Bordit nr. 27/2021, ndryshon dhe bëhet:

“3. shoqëria do të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar jo më vonë se data 17.11.2027”.

2. Pika 4 e dispozitivit të vendimit të Bordit nr. 27/2021, ndryshon dhe bëhet:

“4. Shoqëria do të depozitojë në ERE lejen e përdorimit të burimit ujq të rinovuar jo më vonë se data 25.10.2027”.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë subjektin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti